



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 304, datë 05.06.2023

PËR

**KRIJIMIN E KOMISIONIT TË RISTRUKTURIMIT TË GJYKATËS
ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR DHE VLORË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, nenit 61, 90, 95 dhe 96 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Vendimit të KLGJ-së nr. 272, datë 25.05.2023 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë", Vendimit të KLGJ-së nr. 557, datë 29.12.2022 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit”, të ndryshuar me Vendimin nr. 285, datë 29.05.2023, Vendimit nr. 299, datë 30.05.2023 të KLGJ “Mbi miratimin e rregullave standarde, për organigramën, përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësi të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallë së Parë Lushnjë”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Vlorë, me përbërje:
 - Zj. {...}– Kryetar (përfaqësues i KLGJ-së);
 - Z. {...}– Anëtar (Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë);
 - Z. {...}– Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë);
 - Zj. {...}- Anëtar (Kancelar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë);
 - Zj. {...}- Anëtar (Kancelar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë);
2. Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Vlorë, i cili ushtron funksionet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatës

Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Vlorë, që i nënshtrohet riorganizimit, në strukturën dhe organikën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

3. Komisioni i Ristrukturimit, do të shqyrtojë edhe mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Vlorë, në strukturat e Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR